

BE MBËSHTET REFORMAT E KLSHⁱ

nga Luljeta Nano,

Sekretare e Përgjithshme e KLSH

dhe Albana Agolli,

Drejtoare e Drejtorisë së Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH) përfaqëson institucionin e auditimit suprem në Shqipëri. Reforma është kryer në reflektim të plotë të rekomandimit të Raportit të Progresit të Shqipërisë, të Komisionit European të Tetorit 2012, i cili ka nënvizuar se: *“Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI”*. Gjatë vitit 2012 dhe 2013, u hartuan dhe implementuan programe ambicioze, të inicuar nga Kryetari i KLSH, në aplikim të parimit të menaxhimit institucional efektiv *“Tone at the Top”*, në funksion të reformimit dhe modernizimit të institucionit. Ecuria e performancës së KLSH u pasqyrua edhe në vlerësimet e Raportit të Progresit të Shqipërisë të Komisionit European në Tetor 2013, në të cilin theksohet se *“Në fushën e auditimit të jashtëm, ndryshime organizative dhe procedura të reja janë futur për të shtuar efikasitetin e Institucionit Shtetëror të Auditimit”*. Institucioni njohu një reformë të thellë, e cila u përqëndrua në modernizimin e tij, në përputhje me standardet ndërkombëtare INTOSAI, në kthimin e vëmendjes drejt auditimit të performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar dhe thellimit të luftës kundër korrupsionit, në sinergji me institucionet e tjera publike, duke nxitur qeverisjen e mirë në administrimin e fondeve publike. KLSH ndërmori politika efektive për promovimin e një kulture etike dhe me integritet në institucion, duke e konsideruar si një parakusht për sigurimin e mirëqeverisjes institucionale dhe rritjen e besimit të publikut ndaj tij. Ai ngriti një sistem funksional të rekrutimit të punonjësve, nëpërmjet procedurave të konkurrimit referuar kritereve të mirëpërcaktuara në rrafshin profesional teoriko-praktik, si dhe bazuar në vlerat e integritetit dhe etikës.

KLSH siguroi një menaxhim eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore, nëpërmjet implementimit të një politike pagash bazuar në motivimin dhe nxitjen e karrierës. Institucioni ka forcuar ndjeshëm kapacitetet audituese, me anë të një procesi të vazhdueshëm kualifikimi dhe kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe të gërshetimit të arsimimit me veprimtarinë praktike. Rezultati ka qenë shtimi i cilësisë së auditimeve, veçanërisht të gjetjeve, rekomandimeve dhe ndjekjes së tyre, duke realizuar kontributin për mirëqeverisjen, në përputhje me standardet INTOSAI dhe moton e institucioneve më të larta të auditimit publik *“Experientia mutua Omnibus prodest”* (Nga eksperiencia e përbashkët fitojnë të gjithë). Drejtimi kryesor reformues i sotëm është kryerja e amendimeve në Ligjin organik të KLSH, detyrë kjo e përcaktuar dhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe në rekomandimet e Progres Raporteve 2012 dhe 2013 të Bashkimit Evropian. Në Progres Raportin e fundit nënvizohet se: *“Ndryshimet e Ligjit të KLSH janë që nga viti 2012 nën mbikëqyrjen e Parlamentit dhe mbeten të miratohen nga një shumicë me tre të pestat”*. Gjatë vitit 2012, KLSH realizoi përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit të vet, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE (DG-Budget), me SIGMA-n dhe me ambientet akademike, median e shoqërinë civile të vendit. Nga tryezat e punës të organizuara me palët e mësipërme të interesit, rezultuan sygjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar të Projekt-Ligjit me Amendimet. Ky Projekt-Ligj iu dorëzua Kuvendit të Shqipërisë më 26 nëntor 2012, dhe sipas vlerësimit të DG-Budget *“është tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI”*. Amendimet në ligj rregullojnë pavarësinë e institucionit, realizojnë konceptimin modern të të drejtave dhe detyrave të tij, rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rritjen e kapaciteteve administrative, saktësimin e së drejtës së KLSH të auditojë programet me fondet e akorduara nga BE për

Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit, si dhe saktësimin e së drejtës për të certifikuar llogaritë financiare. Shumë prej tyre janë sygjëruar nga komentet paraprake të SIGMA dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Europian. Projektligji është në përputhje me Deklaratën e Limës, e konsideruar si Kushtetuta e institucioneve të auditimit më të lartë publik si dhe standardet e Auditimit të INTOSAI dhe praktikat më të mira Europiane. Nga data e dorëzimit 26 nëntor 2012 e deri më sot, ende nuk ka ndonjë veprim nga Kuvendi, në drejtim të marrjes në shqyrtim dhe të miratimit të këtij projektligji. Një drejtim tjetër tejet i rëndësishëm për vlerën e shtuar që KLSH i jep shoqërisë dhe ekonomisë së vendit, i thelluar me ndërrimin e filozofisë drejtuese të institucionit, është auditimi i performancës. Ai po shndërrohet gradualisht në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të institucionit. Në përgjigje të kësaj fryme të re, duke e trajtuar me prioritet të lartë auditimin e performancës së institucioneve publike në Shqipëri, KLSH krijoi në muajin Tetor të vitit të kaluar Departamentin e i ri të Auditimit të Performancës. Një pjesë e rëndësishme e planit strategjik të institucionit 2013-2017, është e adresuar për këtë departament. Me synim menaxhimin efektiv të kapaciteteve audituese të këtij departamenti, po punohet në drejtim të profilizimit të audituesve sipas fushave si; shëndetsi, arsim, sektoret social, ndarja administrative etj. Duke matur ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficiencën e burimeve të harxhuara, gjetjet e auditimeve të KLSH ndikojnë në përmirësimin e politikave dhe programeve qeveritare për shërbimet ndaj qytetarëve. Kryerja e auditimeve të performancës, thellimi në këtë fushë, rritja e cilësisë dhe e numrit të auditimeve të këtij lloji është ndër rekomandimet kryesore të BE, përmbajtur në Progres Raportin 2013, ku theksohet se: “...pritet të zbatohet një auditim i qendrueshëm i performancës”. Synimi strategjik i KLSH për vitet 2013-2017 është modernizimi i institucionit për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të

plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI(komuniteti i institucioneve supreme te auditimit te Evropes) 2011-2017, si dhe kontributi për një qeverisje te mire, nëpërmjet luftës pa kompromis dhe në sistem të korrupsionit dhe parandalimit të tij.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 14 Dhjetor 2013